



RAPORTI MUJOR

Maj 2009

Bordi i ZRRE-së

Gjatë muajt maj, Bordi i ZRRE-së ka mbajtur 1 seancë në të cilën ka shqyrtuar dhe ka marrë vendim për këto çështje:

- Ka shqyrtuar dhe ka aprovuar Kodin e Matjes dhe Kodin e Qasjes në Tokë dhe ndërtesa, të NQ Termokos
- Ka shqyrtuar dhe ka marrë vendim që kompanive ATEL nga Zvicra, GSA sh.p.k nga Shqipëria, dhe RUDNAP GROUP AD nga Serbia që t'ju vazhdoj licencën për aktivitetin e tregtisë së energjisë elektrike në Kosovë edhe për dy vjet të tjera.
- Ka Miratuar Formën e Kontratave për furnizim me energji elektrike të KEK Sh.A me konsumatorë shtëpiak dhe komercial.
- Ka shqyrtuar kërkesën e N.Q Gjakova për derogim (shtyrje te afatit) të disa Neneve të Licencave.
- Ka aprovuar Procedurën e Monitorimit të Pajtueshmërisë për Indikatorët e Performancës Teknike dhe Indikatorët Minimal të Performancës Teknike të KOSTT SH.A
- Ka Miratuar ndryshimet në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë dhe Rregullën mbi procedurën e Gjydhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
- Janë Shqyrtuar 11 ankesa të konsumatorëve.
- Ka plotësuar skemën administrative me pozitën e një zyrtari për mbrojtjen e konsumatorëve, në Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorëve .

Departamenti i Furnizimit me Energji dhe Strukturë të Tregut

- Me 06 Maj 2009 - Pjesëmarrje në takim në KOSTT me grupin e KQKO-së.
- 13 Maj 2009 - Pjesëmarrje në takim në ZRRE me përfaqësues të "Air Energy" për Autorizim për ndërtimin e gjeneratorëve me erë.
- 20 Maj 2009 - Pjesëmarrje në takim në ZRRE për Ligjin mbi Rregullatorin e energjisë - komentet.
- 26 Maj 2009 - Pjesëmarrje në takim në MEM për "Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë të Kosovës për përdhën 2009-2011".
- Është punuar në dokumentin Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë të Kosovës për përdhën 2009-2011 dhe janë dërguar komente. Është punuar në prezantimet për ICC. Është punuar në komentet e Planit zhvillimor të KOSTT 2007-2013. Dhe si zakonisht është punuar në raportet mujore dhe ditore të KEK-ut, ato të KOSTT-it, dhe punë tjera standarde dhe të përhershme.

Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave

- Me 6 maj përfaqësuesi i DTÇ ka marrë pjesë në takim në mbajtur mes përfaqësuesve të ZRRE-së dhe përfaqësuesit të komunitetit evropian për energji lidhur me "Contracting Party Mission Electricity Sector"
- Me 14 maj është finalizuar përgatitja e vërejtjeve lidhur me Planin Zhvillimor Afatgjatë 2009-2017 për Divizionin e Gjenerimit.



- Me 15 maj përfaqësuesit e DTC kanë marrë pjesë në Takimin në Ministrinë e Energjisë dhe Minerave, lidhur me procedurën e Autorizimit ose Tenderimit për 18 Hidrocentralet e Vogla në Kosovë
- Me 18 maj 2009 është finalizuar modeli i të Hyrave dhe Tarifave për SHTE3
- Me 20 maj është dërguar modeli i hyrave dhe tarifave të Shqyrtimit të Tretë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE3), dhe aneksi me sqarime plotësuese rreth të dhënave Aktuale të vitit 2008 në Bilancin Energjetik, ngarkesës së pikut dhe kostos së humbjeve.
- Me 20 maj 2009 përfaqësuesit e DTÇ kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur me stafin e ZRRE-së lidhur me komentet e Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë
- Me 29 maj është mbajtur një takim me konsultantin e ZRRE, ku është prezantuar mbi alokimin e të hyrave të lejuara dhe tarifave në mes të kategorive të konsumatorëve dhe është prezantuar modeli tarifor.

Departamenti Ligjor dhe për Licencim

- Takim me përfaqësues të MEM, MMPH dhe MEF lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e HCV.
- Takim me përfaqësuesit të kompanisë "AIR ENERGY"- KITKA-Energji nga Era.
- Takim i stafit të ZRRE-së lidhur me ndryshimet në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- Takim me përfaqësuesit të kompanisë "AKIDU"- nga Bullgaria, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Licencën për furnizim/tregti me energji elektrike.
- Takim i Grupit Punues të ZRRE-së lidhur me vlerësimin e Aplikacionit të kompanisë "HIDROENERGJIA"- për ndërtim të HC në lumen Lepenc.
- Takim me përfaqësues të "KELKOS" dhe pranimit aplikacionin për Transfer të Licencës për gjenerim të energjisë elektrike nga TGC-INC në KELKOS.
- Takim me përfaqësuesin e të licencuarit "RUDNAP GROUP"-Serbi.
- Takim me përfaqësues të Kompanisë "KTW"-energji me erë.

Aktivitetet e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK)

- DMK gjatë muajit maj, 2009 ka regjistruar 29 ankesa të konsumatorëve, ka zgjidhur 30 ankesa të konsumatorëve, ka nxjerrë 23 Vendime, ka përgatitur 2 – Rekomandime për Bordin dhe ka ndërmjetësuar në 5 marrëveshje mes konsumatorëve dhe KEK;
- DMK gjatë muajit maj, 2009 ka pasur 75 biseda të drejtpërdrejta dhe 10 biseda telefonike me palë.
- Me datë 05.05.2009 përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur me stafin e ZRRE-së lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e tre rregullave të ZRRE-së.
- Me datë 20.05.2009 përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur me stafin e ZRRE-së lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e tre rregullave të ZRRE-së.
- Me datë 26.05.2009, përfaqësuesit e DMK-së ka marrë pjesë në takimin e tetë të Grupit Punues për standarde e kualitetit të furnizimit dhe kualitetit të shërbimit
- Me datë 29.05.2009 përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur me stafin e ZRRE-së lidhur me termat e referencës për Standardet e kualitetit të furnizimit dhe kualitetit të shërbimit.

Aktivitetet lidhur me Ngrohjen Qendrore dhe Gazin

- Me 06/05/2009 është mbajtur takimi me Kryetaren e dhe stafin profesional të Komisionit Parlamentar për tregti, industri, energjetikë ... lidhur me Ligjin e gazit natyror dhe komentet e ZRRE në këtë draft. Përgatitja e raportit / informatës nga ky takim.



- Janë shqyrtuar Raportet TM1 të dorëzuara nga NQ Termokos, si dhe janë përgatitur komente dhe vërejtje në lidhje me to.
- Janë shqyrtuar Raportet TM1 Të dorëzuara nga NQ Gjakova, si dhe janë përgatitur komente dhe vërejtje në lidhje me to.
- Është përfunduar analizimi dhe finalizimi i Kodit të Matjes dhe Kodit për Qasjen e Tokë dhe Ndërtesa të NQ Termokos, si dhe janë përgatitur prezantimet e këtyre kodeve për paraqitje para Bordit të ZRRE-së për aprovim në mbledhjen e datës 27.05.2009.
- Është pranuar dhe Analizuar kërkesa e pranuar nga NQ Termokos për lejimin e shkyçjeve kolektive të konsumatorëve të ngrohjes.

Zyra e Administratës

Aktivitetet Financiare

- janë kryer pagesa për
 - 1) paga në shumë prej..... 24,430.35 euro
 - 2) mallra dhe shërbime19,616.83 euro
 - 3) shërbime komunale.....609.30 euro
- është tërhequr një avans për udhëtim zyrtar jashtë vendit, ndërsa dy tjera janë mbyllur
- është kryer regjistrimi i të hyrave në sistemin e free- balancit në shumë prej 74,901.27 euro
- është bërë kërkesë në MEF për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale për dy projekte në shumë prej 112,000.00 euro

Aktivitetet e Prokurimit

- Anulimi i aktivitetit të prokurimit "Publikimi i shpalljeve dhe njoftimeve në shtypin ditor".
- Zhvillimi dhe përfundimi i aktivitetit të prokurimit: Sigurimi dhe TPL+ i automjetit Golf",
- Zhvillimi dhe përfundimi i aktivitetit të prokurimit "Furnizim me external USB hard drive 500 GB.
- Zhvillimi dhe përfundimi i aktivitetit të prokurimit "Furnizim me antivirus package"
- Zhvillimi dhe përfundimi i aktivitetit të prokurimit "Furnizim me tonera për printer me ngjyra".
- Inicimi i aktivitetit të prokurimit "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" , procedurë e hapur,ky aktivitet është në proces.
- Zhvillimi dhe përfundimi i aktivitetit të prokurimit "Shërbime të furnizimit me rrjet kabllovik",
- Aktivitete tjera të lidhura me fushën e prokurimit, monitorimi i realizimit të kontratave, furnizimi me artikuj shpenzues për nevoja të zyrës, etj.

Aktivitete të tjera

- Me 4 maj kryesuesi i Bordit të ZRRE-së Z. Ali Hamiti ka marrë pjesë në një takim pune në MEM në lidhje me dakordimin për fillimin e procedurës për dhënien me koncesion të hidrocentraleve të vogla
- Përfaqësuesit e ZRRE-së kanë marrë pjesë në takimin e Grupit teknik punues për vlerësimin e studimit e fizibilitetit për HC Zhur.
- Me 04 Maj 2009 përfaqësuesit e ZRRE-së kanë marrë pjesë në takimin përgatitor në MEM për takimin me ECS.
- Me 06 Maj 2009 është mbajtur një takim në ZRRE me konsulentet e projektit të Bankës Botërore, firma MERKADOS, për të diskutuar "analizat e potencialeve dhe kostove për energjinë e prodhuar nga resurset e ripërtitshme".



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

- Stafi menaxherial i ZRRE-së ka mbajtur Takim me Përfaqësuesit e Sekretariatit të Komisionit Evropian për Energji
- Anëtar të stafit të ZRRE-së kanë marrë pjesë në takimin në MEM, me STM – infrastruktura në të cilin ZRRE-ja ka prezantuar për kompetencat, pavarësinë dhe financimin e saj.
- Me 8 maj Kryesuesi i ZRRE-së ka marrë pjesë në Ceremoninë e mbajtur nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë me rastin e Ditës së Evropës
- Me 13 maj në ZRRE Bordi ka mbajtur një takim me përfaqësuesit e USAID-it, takim ka qenë konsultativ dhe ka pasur për qëllim vazhdimin e përkrahjes me konsulentë nga USAID.
- Me 26 maj është mbajtur një takim me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ECLO), dhe përfaqësuesit e USAID-it për koordinimin e përkrahjes teknike nga këta dy donator.